

KËRKESË
Nr. 33/5, datë 19.8.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Banesa e Toptanasve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi”, konfirmuar me çmim mesatar shitblerjesh nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore, Tirana Veri, me shkresën nr. 2482/5 prot., datë 17.8.2021, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 178 694 456 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

KRYETAR I
KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Klodiana Guci

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘BANESA E TOPTANASVE’, MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. truall (m²)	Sip. e prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lek/m²)	Vlera truall i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		Çmimi për objekt banimi (lek/ m²)	Vlera sip. e prekur objekti shërbimi, me situacion (lek)	Vlera sip. e prekur objekt banimi (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim nga ASHK-ja Tiranë	SHËNIME
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	BP Këllezi, Kosova, Zajmi, Hoxholli, Permeti, Podgorica, Kazazi, Pashollari, Përgu, Llapaj, Cara, Skenderi, Stermasi, VI&VI sh.p.k.	8150	1/65	1569	1569	66969	105074361	424.00	424.00	0.00	424.00	173632.30	0.00	73620095.2	178694456	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020 dhe 2482/5, datë 17.8.2021, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Veri	Në seksionin D të kartelës së pasurisë ka shënimin: “Në bazë të kontratës së nr. 683/204, datë 30.3.2009, notere Alma Poshi, kjo pasuri është me qira për 10 vjet.
VLERA TOTALE PARAPRAKE					1569										178694456		

SHËNIM:

- Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020 të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.
- Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
- Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.

